



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 55**

Datë: 28. 08. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuviq, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

2. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike

3. Të ndryshme

---

## **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë, po hapim mbledhjen e 55-të të KQZ-së. Komisioni është në përbërje të plotë ,rendin e ditës e keni para vetes ,do të thotë i kemi aktivitetet e zyrës por nuk do të merremi me aktivitetet ,por do të vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike dhe të ndryshme.

A ka dikush diçka me shtuar lidhur me agjendën ?

**Arianit Elshani** : Kam një rekomandim për një pikë shtesë që besoj që duhet të diskutohet në mbledhjen e sotme lidhur me kërkesën e KQZ-së për zëvendësimin e kandidatëve të cilët kanë ra ndesh me pikën q të nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme , lidhur me ato rekomandime që kanë ardhë nga KGJK-ja ,mendoj që KQZ duhet të marrë një vendim mbi të cilin refuzon kandidatët të cilët nuk kanë plotësuar këtë kriter, të cilin realisht edhe Gjykata Kushtetuese edhe Gjykata Supreme dhe PZAP-ja në zgjedhjet e fundit ka marrë vendim lidhur me këtë çështje. Mirëpo, mendoj se nuk duhet tua mohojmë të drejtën për tu ankuar kandidatët të cilët janë zëvendësuar nga subjektet politike meqenëse dje kemi pa një vendim nga PZAP me të cilin janë shpallur të palejueshme kërkesat për shqyrtimin e refuzimit të kandidaturës të tyre dhe mendoj qe KQZ ua ka mohuar të drejtën për tu ankuar kandidatëve duke lejuar vetëm të drejtën e subjektit politik për të ruajtur vendin e tyre për kandidatura për asamble komunale edhe kryetar, mendoj që duhet ta diskutojmë ,të jetë si pikë e rendit të ditës ,të diskutohet kjo çështje dhe të merret një vendim lidhur me ofrimin e mundësisë për të gjithë kandidatët të cilët janë zëvendësuar të kenë një bazë ligjore për tu ankuar më tutje në PZAP dhe në Gjykatë Supreme...

**Sami Kurteshi** : Unë, e kam një pikë shtesë për rendin e ditës dhe ajo është njoftim lidhur me mbledhjen e fundit të Komunitetit të Auditimit...

**Kreshnik Radoniqi** : Atëherë, a pajtoheni me këtë rend të ditës me këto dy pika që shtohen nga z. Elshani, dhe z. Kurteshi ? Kush është për ?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

## 2. Aktivitetet e ZRPPC-së:

### Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike dhe numrin e kandidatëve për kovendet komunale për Zgjedhjet Lokale 2021

**Ylli Buleshkaj** : Fillimisht, na vjen keq që jemi vonue, por deri para pak momenteve kemi pranuar shkresa nga institucionet e ndryshme. Falënderojmë publikisht edhe KGJK-në që ka punuar edhe ditën e shtunë në mënyrë që të na sigurojë që të gjithë kandidatët janë në përputhje me germën “q” të nenit 29 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kemi pranuar shkresa edhe gjatë vikendit për të na ndihmuar, dhe para jush i kemi paraqitur rekomandimet e zyrës...

Ka qenë një punë e madhe dhe besoj që mund të ketë edhe ndonjë lëshim të mundshëm sepse, kemi të bëjmë me mbi 5000 kandidatë në 38 zona zgjedhore dhe dy parë zgjedhje për secilën zonë zgjedhore...

**Kreshnik Radoniqi**: Shkojmë me atë parim, sikur pardje...

**Ylli Buleshkaj**: Atëherë, partia e cila rekomandohet për certifikim është partia Ura e cila garon në Mitrovicën e Jugut me 8 kandidatë për Kuvend Komunal.

**Kreshnik Radoniqi**: A ka dikush diçka lidhur me subjektin politik partia Ura ? Kush është për certifikimin e partisë Ura?

Me vota unanime certifikohet partia politike Ura për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: E dyta me radhë është organizata Balli Kombëtar Demokrat që garon në dy komuna, në Podujevë me kandidat për kryetar komune dhe me 16 kandidatë për kuvend komunal, ndërsa në Viti me 6 kandidatë për kuvend komunal, nga këta 6 , 5 rekomandohen për tu certifikuar ndërsa njëri jo, e keni në vendim pastaj sepse, i njëjti është gjetur dhe identifikuar nga KGJK që ka një vepër...

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Dhe mos certifikimin e njërit prej kandidatëve i cili nuk i ka plotësua kushtet për me qenë pjesë e listës, kush është për ?

Me vota unanime miratohet ky rekomandim.

**Ylli Buleshkaj**: Partia politike e radhës është Srpska Lista. Garon në Gjilan për kuvend komunal me 15 kandidatë, në Klinë me 12 kandidatë, në Fushë Kosovë me 3 kandidatë, në Kamenicë me 11 kandidatë, në Leposaviq me kandidat për kryetar komune dhe me 21 kandidatë për kuvend komunal, në Lipjan me 5 kandidatë për kuvend komunal, në Novobërdë me një kandidat për kryetar komune dhe me 16 për kuvend komunal, në Obiliq me kandidat për kryetar komune dhe 13 për kuvend komunal, në Rahovec me 2 kandidatë për kuvend komunal, në Pejë me 11 kandidatë, në Prishtinë me 2 kandidatë për kuvend komunal, në Skenderaj me 1 kandidat për kuvend komunal, në Shtërpçë ka kandidat për kryetar komune dhe 17 për kuvend komunal, në Vushtrri janë 10 kandidatë për kuvend komunal, në Zubin Potok e ka një kandidat për kryetar komune dhe 21 për kuvend komunal, Zveqan janë një për kryetar komune dhe 21 për kuvend komunal, Graçanicë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Mitrovicë e Veriut kanë kandidatë për kryetar komune, në Zveqan 21 për kuvend komunal, Graçanicë 21 për kuvend komunal, Ranillug 17 Partesh 17, dhe Kllokot 17 kandidatë për kuvend komunal. Mitrovicë e Veriut me 21 kandidatë dhe Istog me 13. Ka pas disa raste që janë identifikuar nga KGJK, dhe ky subjekt i ka zëvendësuar...

**Kreshnik Radoniqi**: Nëse nuk ka dikush diçka, a mundemi me votu për certifikimin e partisë politike Srpska Lista ?

Me vota unanime certifikohet partia politike Srpska Lista për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Partia politike e radhës është Partia Lëvizja për Bashkim të cilët garojnë në Obiliq për kryetar komune dhe me 23 kandidatë për kuvend komunal, në Vushtrri me 22 kandidatë për Kuvend komunal, në Shtime me 15, dhe në Prishtinë me 23 kandidatë.

**Kreshnik Radoniqi**: Nëse nuk ka dikush diçka a mundemi me votu ? Kush është për ?

Me vota unanime certifikohet partia politike Lëvizja për Bashkim për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Partia e Drejtësisë garon për kuvend komunal: në Podujevë 33, Gjakovë më 5, në Gjilan me 13, Mitrovicë e jugut me 18 kandidatë...

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë kush është për certifikimin e kësaj partie ?

Atëherë me vota unanime certifikohet partia politike Partia e Drejtësisë për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Partia Kosova Demokratik Turk Partisi garon me 3 kandidatë për kryetar komune

në Prizren, Vushtrri dhe Mamushë dhe në 6 kuvende komunale, në Gjiilan me 10 kandidatë, në Mitrovicë të Jugut me 7, në Prishtinë me 12 ,Prizren 22 , Vushtrri 3 dhe Mamushë 17.

**Kreshnik Radoniqi**: Nëse nuk ka dikush diçka atëherë ,kush është për ? Atëherë me vota unanime certifikohet partia politike Kosova Demokratik Turk Partisi për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: Partia politike e radhës e cila rekomandohet për certifikim me kandidatët e saj është Lidhja Demokratike e Kosovës e që ka kandidat për kryetar komune në Deçan, Gjakovë, Gllogoc, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Rahovec, Prishtinë, Ferizaj, Vushtrri, Malishevë, Junik, Gjiilan , Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Pejë, Podujevë,

Prizren, Shtime, Suharekë , Viti, Zubin Potok , ndërsa me kandidatë për kuvend komunal garon në Deçan me 29, Gjakovë 35, Gllogoc 9, Dragash 24, Istog 29, Kaçanik 29, Klinë 29 ,Kamenicë 27, Mitrovicë e Jugut 38, Novobërdë 16, Rahovec 34, Prishtinë 56, Skenderaj 7, Ferizaj 42, Vushtrri 38, Malishevë 30, Junik 16, Gjiilan 38, Fushë Kosovë 29, Lipjan 34, Obiliq 21, Pejë 38, Podujevë 38, Prizren 45, Shtime 19, Suharekë 34, Viti 29, Zubin Potok 8, Kllokot 6, Hani i Elezit 40.

**Kreshnik Radoniqi**: A ka dikush diçka lidhur me ? Atëherë hedhi në votim. Kush është për ? Me vota unanime certifikohet partia politike Lidhja Demokratike e Kosovës për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Partia politike e radhës është Partia e Ashkalinjve për Integrim të cilët garojnë në Lipjan me 9 kandidatë për asamble komunale dhe në Shtime me 1 kandidat.

**Kreshnik Radoniqi**: Nëse nuk ka dikush diçka atëherë, kush është për ? Atëherë me vota unanime certifikohet partia politike Partia e Ashkalinjve për Integrim për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: Partia politike e radhës është Lëvizja Vetëvendosje të cilët garojnë më kandidatë Për kryetar komune në komunat si në vijim Deçan, Gjakovë, Gllogoc, Gjiilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Shtërpcë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Malishevë, Junik, Hani i Elezit, ndërsa kanë kandidatë për kuvende komunale në Deçan 28, Gjakovë 38, Gllogoc 34, Gjiilan 38, Dragash 21, Istog 29, Kaçanik 29, Klinë 29, Fushë Kosovë 29, Kamenicë 29, Mitrovicë e Jugut 37, Leposaviq 3, Lipjan 34, Novobërdë 16, Obiliq 23, Rahovec

34, Pejë 38, Podujevë 38, Prishtinë 56, Prizren 45, Skenderaj 34, Shtime 23, Shtërpçë 8, Suharekë 34, Ferizaj 45, Viti 29, Vushtrri 38, Zubin Potok 12, Malishevë 34, Junik 15, Mamushë 9, Hani i Elezit 15, Killokot 7, Zveqan 2.

**Kreshnik Radoniqi**: A ka dikush diçka lidhur me ? Atëherë hedhi në votim. Kush është për certifikimin ? Atëherë me vota unanime certifikohet partia politike Lëvizja Vetëvendosje për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: Partia politike e radhës është Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës të cilët garojnë në Lipjan për kuvend komunal me 4 kandidatë, kanë pas edhe një kandidat i cili është tërhequr pasi ka marrë njoftimin nga KGJK.

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë kush është për? Atëherë me vota unanime certifikohet partia politike Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: Partia politike e radhës është Partia Demokratike e Kosovës, por nga kolegu ynë u njoftuam që mund të kemi në dy tri komuna edhe ndryshimet në numra për sa i përket asamblistëve dhe pastaj, do të bëjmë plotësimet ashtu siç është e nevojshme ndërsa kandidatët për kryetar të komunave janë ata të saktit ,i rekomandojmë për certifikim.

PDK ka kandidatë për kryetar komune në Gjakovë, Glllogoc, Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Laposaviq, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Malishevë, Junik, Hani i Elezit dhe Deçan.

Ndërsa garojnë për kuvend komunal në Gjakovë me 36, Glllogoc me 34, Gjilan 37, Dragash 25, Istog 29, Kaçanik 29, Fushë Kosovë 29, Kamenicë 21 ,Mitrovicë e Jugut 38 ,Laposaviq 5 , Lipjan 32, Novobërdë 11 ,Obiliq 21 , Rahovec 34 , Pejë 36, Podujevë 37, Prishtinë 56... Këta numra mund të ju kenë rrjedhur kolegëve të mi, po secili kandidat i cili është në listë, është verifikuar ashtu siç ka ardhur...

**Kreshnik Radoniqi**: A keni nevojë , ndoshta me i rishiku ?

**Ylli Buleshkaj**: Ne, mundemi me i rishikuar, në qoftë se numrat qe na jep z. Elshani nuk janë të saktë... Atëherë ne mund ti rishikojmë

**Kreshnik Radoniqi**: A po e lëmë Partinë Demokratike për momentin ? Nuk po e shtyjme shumë, veç derisa zyra t'i verifikoj...

**Ylli Buleshkaj**: E bëjmë një pushim 5 minutësh, i verifikojmë.... Mirëpo, mund t'i votojmë kandidatët për kryetar komune...

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë, vetëm kandidatë për kryetar të komunave. Kush është për certifikimin e kandidatëve për kryetar të komunave të Partisë Demokratike ?

Me vota unanime certifikohen kandidatët për kryetar të komunave nga radha e partisë politike Partia Demokratike e Kosovës, ndërsa për asamblistë do ta shqyrtojmë mandej pas verifikimit nga zyra...

**Ylli Buleshkaj**: Nisma Socialdemokrate e Kosovës garon me kandidat për kryetar komune në Gjakovë, Kamenicë, Podujevë, Prizren, Vushtrri dhe Malishevë, ndërsa për kuvende komunale në Gjakovë me 38 kandidatë, Glllogoc 6, Kaçanik 12, Fushë Kosovë 21, Kamenicë 12, Mitrovicë e Jugut 19, Gjilan 5, Podujevë 8, Prishtinë 12, Prizren 34, Skenderaj 10, Shtime 8, Suharekë 13, Prizren 22, Vushtrri 35 dhe Malishevë 34.

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë kush është për certifikimin e Nismës Socialdemokrate ? Atëherë me vota unanime certifikohet partia politike Nisma Socialdemokrate për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Partia politike e radhës është rekomandua për certifikim është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës të cilët kanë kandidatë për kryetar komune në Deçan, Gjakovë, Glllogoc, Gjilan, Dragash, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Lipjan, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Ferizaj, Vushtrri, Malishevë dhe Junik. Ndërsa, kanë kandidatë për asamble komunale për Deçan 29, Gjakovë 38, Glllogoc 24, Gjilan 33, Dragash 10, Istog 29, Klinë 29, Fushë Kosovë 11, Kamenicë 26, Lipjan 14, Obiliq 22, Rahovec 34, Pejë 38, Podujevë 38, Prishtinë 56, Prizren 41, Suharekë 34, Ferizaj 44, Vushtrri 20, Malishevë 24, Junik 17, Kaçanik 25, Mitrovicë e Jugut 7, Skenderaj 21, Shtime 6, Viti 13, Han i Elezit 17 dhe Klllokot 1. Këta janë ata të cilët rekomandohen për certifikim, ndërsa një kandidat i këtij subjekti politik nga Glllogoci, dy nga Gjilani, një nga Fushë Kosova, një nga Lipjani, një nga Ferizaj, një nga Malisheva dhe një nga Mitrovica e Jugut rekomandohen për tu mos certifikuar për shkak se janë në kundërshtim me pikën "q" të nenit 29...

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë a ka dikush diçka...?

**Sami Kurteshi**: Është ndjekë procedura e njëjtë kur të gjithë i keni dërgua kërkesë për zëvendësim, d.m.th, subjekti politik nuk i ka zëvendësuar...

**Ylli Buleshkaj**: Vetëm të japë një përgjigje teknike: subjekti politik i ka zëvendësuar shumicën e atyre të cilët është kërkuar, këta të cilët nuk janë zëvendësuar janë ata të cilët kanë zgjedhur ta ndjekin rrugën ligjore për të kërkuar përfshirje në listën e kandidatëve.

**Kreshnik Radoniqi** Atëherë fillimisht certifikimi: kush është për certifikimin e partisë politike me kandidatë ? Me vota unanime certifikohet partia politike Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës për zgjedhjet lokale 2021, me kandidatë që i lexoi z. Buleshkaj.

Lidhur me mos certifikimin: kush është për mos certifikimin e 8 kandidatëve ?

Me vota unanime, refuzohet certifikimi i 8 kandidatëve.

**Ylli Buleshkaj**: Partia e radhës është Aleanca Kosova e Re që kanë kandidatë në Prishtinë dhe Prizren për kryetar, kurse asamblistë kanë në Gjilan 28, Fushë Kosovë 6, në Mitrovicë të jugut 16, Lipjan 3, Prishtinë 17, Skenderaj 19, Prizren 28, Shtime 15, Ferizaj 21, dhe Viti 14.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Me vota unanime certifikohet partia politike Aleanca Kosova e Re për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: Subjekti i radhës, është Iniciativa Qytetare për Skenderaj që kanë kandidate për kryetar komune, dhe 17 kandidatë për kuvend komunal. .

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ?

Atëherë me vota unanime certifikohet Iniciativa Qytetare për Skenderaj për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Subjekti i radhës është Erdem që kanë kandidatë për kryetar komune në Mamushë, dhe 5 kandidatë për kuvend komunal

**Kreshnik Radoniqi** : Kush është për ? Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Iniciativa Erdem për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Subjekti i radhës është Iniciativa për Kllokot që kanë 6 kandidatë komunal...



**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ?

Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare për Kllokot për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj:** Subjekti i radhës iniciativa qytetare Iniciativa e Therandës me 21 kandidatë për kuvend komunal.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ?

Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Iniciativa e Therandës për Zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj:** Subjekti i radhës është Reformimi Demokratik për Ferizaj ka 12 kandidatë për kuvendin komunal të Ferizajt të cilët, i rekomandojmë për certifikim

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ?

Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Reformimi Demokratik për Ferizaj për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj:** Iniciativa e radhës është Lista e Pavarur Bekim Jashari nga Skenderaj të cilët, e kanë një kandidat për kryetar komune dhe, 34 për kuvend komunal.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Lista e Pavarur Bekim Jashari për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj:** Subjekti i radhës është iniciativa qytetare Shqiptarët e Bashkuar të cilët garojnë në Graqanicë me 5 kandidatë për kuvend komunal të Graqanicës.

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Shqiptarët e Bashkuar për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj:** Subjekti i radhës është Grajancka Iniciativa Srpka Obstanak nga Mitrovica e Veriut të cilët e kanë një kandidat i cili rekomandohet për kuvendin komunal ndërsa kandidati I tyre për kryetar komune i cili ka qenë edhe kandidat për kuvendin komunal, por i njëjti nuk është zëvendësuar...

**Kreshnik Radoniqi:** Ka qenë ai i njëjti edhe për kandidat për kryetar ? Atëherë mbetet vetëm një, pra kush është për certifikimin ?

Atëherë certifikohet iniciativa Grajancka Iniciativa Srpska Obstanak për zgjedhjet lokale 2021 me një kandidat për kuvend komunal.

Kush është për mos certifikimin e njërit kandidat të kësaj iniciative qytetare për shkak që nuk i përmbush kushtet ?

Me vota unanime, do të thotë refuzohet certifikimi i kandidatit të kësaj iniciative për kryetar komune dhe për kuvendin komunal.

**Ylli Buleshkaj:** Subjekti i radhës, është Progresi për Skenderaj me 22 kandidatë...?

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ?

Atëherë, me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Progresi për Skenderaj për zgjedhjet lokale 2021, me 22 kandidatë.

**Ylli Buleshkaj:** Iniciativa e radhës është Narodno Jedinstvo nga Klllokoti të cilët e kanë një kandidat

Për kryetar komune dhe 8 për kuvend komunal të Klllokotit.

**Kreshnik Radoniqi :** Kush është për ? Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Narodno Jedinkso për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj:** Iniciativa e radhës është Grajancka Iniciativa Srpska Narodna Sloga poashtu e Klllokotit të cilët garojnë për kryetar komune me një kandidat dhe për asamble me 14.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Grajancka Iniciativa Srpska Narodna Sloga për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj:** Subjekti i radhës është Lista Ndryshe të cilët garojnë në Fushë Kosovë, me 16 kandidatë për kuvendin komunal të Fushë Kosovës.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Lista Ndryshe për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Subjekti i radhës është iniciativa Forca e Diasporës të cilët garojnë me 26 kandidatë për kuvendin komunal në Mitrovicën e Jugut .

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për ? Atëherë me vota unanime certifikohet iniciativa Forca e Diasporës për zgjedhjet lokale 2021

**Ylli Buleshkaj**: Subjekti i radhës është iniciativa qytetare Demokratet për Drenas të cilët garojnë me kandidate për kryetare komunë dhe 34 kandidatet për kuvendin komunal në Drenas. Ky është ai rasti i ndërrimit të emirit që e kemi pasur.

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë kush është për. Me vota unanime, certifikohet iniciativa qytetare Demokratet për Drenas për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: Iniciativa e radhës qytetare është, iniciativa qytetare Mitrovica e cila garon në Mitrovicën e Veriut me një kandidate për kryetare komunë dhe 15 për kuvend komunal.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për, me vota unanime certifikohet iniciativa qytetare Mitrovica për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: Iniciativa qytetare Narodna Slloga kërkon të garoj në Paretsh me kandidatë për kryetar komune dhe me 13 kandidate për kuvend komunal të Parteshit.

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë kush është për, certifikohet iniciativa qytetare Narodna Slloga për Paretsh për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj**: kandidati i radhës është kandidat i pavarur Selajdin Bytyqi i cili garon edhe për kuvend komunal edhe për asamble komunale në Malishevë.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për, certifikohet kandidati i pavarur Selajdin Bytyqi për zgjedhjet lokale 2021 me vota unanime.

**Ylli Buleshkaj**: Kandidati i radhës është Hamdi Malaj i cili garon për kuvend komunal në Skenderaj.

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë kush është për, me vota unanime certifikohet kandidati i pavarur Hamdi Malaj për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj** : kandidati tjetër është Shukri Luta i cili garon në Kaçanik për kryetar komune.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për, me vota unanime certifikohet kandidati i pavarur Shukri Luta për zgjedhjet lokale 2021.

**Ylli Buleshkaj:** ndërsa nga hera e kaluar na ka mbetur z. Gani Veselaj i cili garon në kuvendin komunal të Pejës për kryetar komune.

**Kreshnik Radoniqi:** Për kryetar komune, atëherë kush është për certifikohet kandidati i pavarur Gani Veselaj për zgjedhjet lokale 2021 me vota unanime.

**Ylli Buleshkaj:** fillimisht na vjen keq qe na ka ndodh gabimi aç me pak te një parti e madhe. Të dhënat që i shqyrtuam dhe pamë janë kandidatit për Gjakove ku Partia Demokratike e Kosovës, i ka 36 për Drenas, Gjilan 36, Dragash 25, Istog 29, Kaçanik 29, Klinë 29, Fushe Kosovë 29, Kamenice 21, Mitrovicë Jugut 38, Leposaviq 5, Lipjan 32, Novobërde 11, Obiliq 21, Rahovec 34, Peje 36, Podujeve 38, Prishtine 56, Prizren 45, Skenderaj 34, Shtime 23, Suhareke 34, Ferizaj 45, Viti 29, Vushtrri 38, Zubin Potok 5, Zveçan 2, Malisheve 34, Junik 9, Mamushë 2, Han Elezi 17, Klikonte 7, Deçan 12.

**Kreshnik Radoniqi:** Mirë, atëherë e hedhim në votim. Kush është për certifikime PDK-se, me vota unanime certifikohet Partia Demokratik Kosovës përzgjedhjet lokale 2021.

Për kryetar komune u krye, në rregull...Po urdhëro, z. Gashi?

**Illir Gashi:** Unë mendoj që zyra do të ja përcill pastaj subjekteve politike të gjithë data bazën listën që janë certifikuar në mënyre që edhe një here të jepet një mundësi se eventualisht ka majtë të rrjedh ndonjë gabime në qoftë numrin qoftë emëruat apo diçka tjetër, të jemi korrekt.

**Ylli Buleshkaj:** Në qofte së me lejohet: Zyra, do t'i përcjell secili subjekt listën fillimisht, e pastaj do të bëjë publike edhe për publikun e gjerë....

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë kryesues, ashtu siç e thash edhe në propozimin tim lidhur me këtë pike mendoj së si anëtarë të KQZ-se duhet të diskutojmë lidhur me një rekomandime i cili mund të vijë nga ky diskutime që, do ta zhvillojmë lidhur me vendimin për refuzimin e të gjithë atyre kandidateve të cilët kane pasur për arsye te ndryshme nuk janë përfshire në listën e kandidateve për tu rekomanduar për certifikime. Ne, e dimë që disa subjekte politike duke e përfshi edhe PDK-ne ka konsumuar të drejtën e saj nga obligimi qe është dale nga zyra për regjistrimin e partive politike lidhur më zëvendësimin e kandidateve më qenë se janë obliguar partitë politike në

një mënyre që mos të hupin të drejtën për të garuar në komuna me përbërje të plote të asambleve komunale këshilltareve komunal dhe për candidate për kryetare komune. Mirëpo, nga kjo e drejtë me pas në PZAP, ju është mohuar e drejta e shqyrtimit të kërkesës për zëvendësim, andaj mendoj që duhet të shikojmë një mundësi që të krijojmë një baze ligjore pra të marrim një vendim lidhur me çështjen e rekomandimit të zyrës në raport me partitë politike kur kanë kërkuar zëvendësimin e këtyre candidateve. Pra, besoj se këtu, secili ka diçka për të thënë lidhur me këtë. Propozoj që të merret një vendim lidhur me refuzimin e candidateve dhe kërkesën për zëvendësimin e tyre...

**Sami Kurteshi:** Faleminderit z. Kryesues, realisht kjo pikë ka të bëjë me një vendim që kemi marr më 14 shkurt, e ka qenë problematik dhe, mendoj se PZAP-ja nuk ka vepruar drejt kur nuk i ka shqyrtuar kërkesat sepse, nuk ka vendim nga KQZ-ja. Vendimi për certifikime, d.m.th momenti i certifikimit, është vendim i KQZ-se. E, do duhej me u trajtuar këtu, këta nuk e kanë trajtuar kështu që unë pajtohem me këtë se, secilit person i jepet e drejta për të sfiduar ligjërisht çdo vendim të çdo institucioni që e cenon në çfarëdo mënyre ndonjë të drejt apo obligime të tij. Po, jam për këtë kjo nuk ka qenë në rregull, sepse vërtet momentin e certifikimit nuk e marrin si vendim dhe, ajo është një akt i një institucioni sido që ta këtë emirin dhe, do të duhej me u marr parasysh ankesa, d.m.th, edhe me u trajtuar por jo më u hedhë poshtë sepse, nuk ka vendim nga KQZ-ja.

**Ibrahim Selmanaj:** Unë, kam një pyetje të përgjithshme të vendimit: në çoftë se një kandidati i refuzohet e drejta gjithë herë duke u bazuar në ligji dhe zëvendësohet po supozojmë, e numri 10 është refuzuar edhe zëvendësohet me një emër tjetër po i njëjti paraqet ankesë dhe e fiton të drejtën përmes PZAP-së ose përmes gjykatës, organi më i lartë e këtë radhë gjykata supreme, çka do të behet me këtë kandidatin ku ky vetëm se ka fituar të drejtën edhe u zëvendësuar? Pyetje e përgjithshme është kjo për me e qartësua situatën kur kemi kësi situatë...

**Ilir Gashi:** Faleminderit Kryesues, po mendoj që çdo shkresë që del nga ky institucione ka implikime dhe, zyra për regjistrime për parti politike nuk është i shkëputur nga ky institucione dhe operon, dhe përgjegjësit e saj janë të lidhura direkt edhe me KQZ-në. Ne, nga ajo çka kemi lexuar në vendimin e PZAP-ës lidhur me një ankesë, del që në një farë mënyre po ja ndalojmë të drejtën të gjithë atyre aplikontve: qofte për kryetar komune qofte për asamble që të ankimojnë. Prandaj, ajo e drejtë është edhe ligjore edhe kushtetuese dhe ne si institucion, do të duhej që të mundësojmë të drejtën e tyre legjitime duke ju dhënë një bazë vendimmarrëse që ata të kenë të drejt të ankohen në instanca të tjera, duke përfshirë edhe PZAP-në. Por, edhe gjykatën supreme dhe pse jo, deri ne

gjykatën kushtetuese. Pavarësisht asaj se ligjet janë në fuqi, ne jemi të obliguar ta respektojmë dhe, sa kanë dhe sa janë frymë demokratike është çështje tjetër! Ne, do të sillemi brenda këtyre kornizave dhe mendoj që ne duhet të i legalizojmë kërkesat e aplikuarve, do të duhej që ne të nxjerrim një vendim ku të gjithë ata aplikantë të cilët janë kthyer nga këshilli gjyqësorë nga KGJK-ja ti refuzojmë duke u bazuar edhe në ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme, ku më pastaj, ata kanë të drejtën e tyre që të ankimojnë mbi vendimet tona sepse, subjektet politike nuk e kanë bërë ndërrimin me dashje dhe e kanë bërë në bazë të një rekomandimi të dalë nga zyra për regjistrimin e partive politike duke u thirrur në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme. Ne, jemi brenda afateve edhe pse deri më datën 8 kur edhe hidhet shorti, mendoj që mund të konsumohen të gjitha instancat gjyqësore të parapara më ligje dhe mbi këtë, ne pastaj jemi në rregull që ne të nxjerrim një vendim të bazuar se edhe ashtu, duhet të nxirret një vendim për t'i refuzuar aplikantët të cilat këshilli gjyqësor ka konsideruar që bien ndesh me dispozitat e ligjit të zgjedhjeve të përgjithshme.

**Alim Rama:** Faleminderit Kryesues, ne ishim ndërlidhë këtu me përgjigjen e z. Selmanaj, e cila është një përgjigje shumë me vend, se çka ndodhë tash kur subjekti vetëm që e ka ndërruar kandidatën...Unë mendoj që zyra ka dhënë rekomandimi e këtyre provave, është një rekomandim i njëjtte më atë që ka ndodhur në shkurt, d.m.th, i takon subjektit politik me vendos se a e zëvendëson ose jo. Nëse zyra ka vendos diçka ndryshe këtë herë, unë mendoj që kërkesa ka qenë gjithmonë e njëjtë: i takon subjektit politik ta zëvendësoj ose jo! Në rast se subjekti politik i ka zëvendësuar disa, e disa i ka lënë mos më i zëvendësuar, atëherë ata kanë të drejtë mu ankuar por ne si KQZ, i vetmi vendim është ky që e kemi...

Ndoshta pas zgjedhjeve, mundemi me e trajtuar me proceduara të tjera. Ne me këto procedura që kemi në vend, nuk mendoj se s'kemi me hapësirë sepse, këto vendime janë marrë me të drejtë ose pa të drejtë, tani ne jemi të obliguar me i zbatuar këto vendime të cilat janë marrë në procesione të fundit. Tash, në qoftë se një proces e kanë trajtuar më ndryshe në raste se ne kemi vendos që kandidatët të sfidojnë deri në fund, tash ka qenë dikush tjetër që ka vendosur më të drejte ose pa të drejte...Unë, kam mendimin tim po tek e fundit ligjore është ajo që ka mbet, por unë mendoj se tash si KQZ-ë, nuk kemi më hapësirë tjetër përveç mënyrës së vendimit për certifikime...

**Florian Dushi:** Atëherë faleminderit kryesues, unë mendoj që kërkesa e kolegeve për të siguruar një bazë mbi të cilën kandidatet do të kishin të drejt më u ankuar rreth mos certifikimit të tyre, është e drejtë në kuptimin ashtu siç kërkon edhe kushtetuta jonë por, edhe konventat e tjera. Ne,

duhet të krijojmë si institucione aq ma tepër për një çështje kaq të rëndësishme kur dikujt i pa mundësohet pjesëmarrja në zgjedhje, mundësi që ky “pamundësim” do ta quaj i certifikimit, ky pamundësim i pjesëmarrjes në zgjedhje të një kandidati të ketë mundësi të sfidohet në organet e parapara me ligje. Pra, ajo që unë konsideroj është më rendësi ta themi këtu, janë dy çështje: e para, është se procedura ose rruga të cilën e ka ndjekur zyra është plotësisht ligjore, është ne përputhje me procedurën e paraparë ligjore, dhe e dyta, ka zbrazëti ligjore sa i përket kësaj pjese të vendimmarrjes, të njoftimit të subjekteve politike të kërkesës nga zyra sepse, vetëm kaq është kërkuar me ligj. Pra, që subjekteve politike të ju kërkohet zëvendësimi i kandidateve në raste se zyra vlerëson që të njëjtit nuk i përmbushin kriteret ligjore. Pra, zyra e ndjek këtë rrugë, ju kërkon subjekteve politike zëvendësimin e tyre. Natyrisht që subjektet politike kanë diskrecion nëse duan i zëvendësojnë nëse nuk duan nuk i zëvendësojnë. Është KQZ-se për ta aprovuar certifikimin ose mos certifikimi e këtyre por, unë konsideroj që ne duhet të shohim mundësinë të analizojmë nëse kemi mundësi që t’u hapim rrugë këtyre kandidateve të cilët i kemi zëvendësuar...

Vërtetë, gjatë këtyre ditëve kemi pasur mundësi që të shohim, edhe pse ne kemi pranuar listën nga këshilli gjyqësorë i Kosovës duke ja dhënë besimin e plote listës së tille por në ndërkohë kemi par raste të çuditshme, vendime aktvendime, vepra që në një fazë është dënuar dhe më nuk përben më tutje vepër penale prandaj, them se këto mundë të jenë pastaj pjesë e interpretimeve tona. Unë, nuk dua me paragjykuar asgjë! Për mua, lista e këshillit gjyqësorë është finale dhe sikur gjithë koleget tjerë edhe sikur vetë zyra, ja kemi falur besimin e plotë por megjithatë, ajo se çfarë ka vendosur PZAP në anën tjetër, po ashtu, më të drejtë sepse ne e dimë që vendimet e KQZ-së apelohe në PZAP... Atëherë, çfarë baze mund të kenë këta kandidatët për tu ankuar ? Megjithatë, unë jam në favore që kjo të shihet dhe të ju mundësohet kandidatëve që të ankohen. Ne e dimë nga praktika se çështja të bie ndesh me nenin 29 germën “ç”, e dimë që jo njëherë ka arritur të shqyrtohet në forma të ndryshme deri në gjykatën kushtetuese dhe kjo tash me për mua, personalisht edhe për shume tjerë, është krejtësisht e qartë por megjithatë ka prej tyre që pretendojnë se kanë të drejtë, dhe ketë mundësi do të duhej me ua lejuar.

**Sami Kurteshi:** Unë po e përsëris edhe një here atë përzierjen që e benë PZAP-ja ne e kemi nenin 119 ankesa të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë që thotë 119 paragrafin 3. PZAP nuk merr parasysh një ankese që ka të beje më vendim nga ana e KQZ-se por do te mundet të shqyrtoje një apel ndaj një vendimi të KQZ-se siç është saktësuar në nenin 122 të këtij ligji. Dhe këtu ata e

përzien dhe nuk shoh arsye prej nga del prej këtij formulimi çfarë do qoftë, e drejta e PZAP-së me e refuzuar një ankese ose një apel nga neni 122 pika B e paragrafit të parë thotë çka duhet të apelohehet!? Unë nuk e di se si është e mundur që PZAP-ja me refuzuar diçka të tillë. Janë dy mundësi: edhe ankesa më u bërë brenda 24 orëve që është për çfarëdo çështje por, edhe me u apeluar në raport me certifikimin ose kundërshtimin...Unë, nuk po e kuptoj nga gjuha nuk jam gjuhëtari më i mirë por si juristë, nuk po mundem me marrë me mend se cila është ajo bazë norme që e ndalon ankesën ose apelin ndaj çfarë do veprimi ndaj aktit të një institucioni që e cenon të drejtat e dikujt...

**Arianit Elshani**: Faleminderit shumë, unë siç e thash edhe në fillim, shkresa e dal nga zyra për regjistrimin e partive politike realisht, mund të kuptohet si një vendim i KQZ-së më qenë se KQZ-ja ka marr një vendim në zgjedhjet e shkurtit dhe ky vendim dhe shkresë, është e bazuar pastaj në vendimin e gjykatës supreme dhe të PZAP-se në zgjedhjet e shkurtit. Si të tillë, ZRPPC-ja nuk ka mundur të ofrojë mundësi tjetër shtesë në raport me kandidatët dhe me subjektet politike prandaj, siç e thanë edhe të tjerët, konsiderohet një forme që shkresa e zyrës së regjistrimit të partive politike në raport me subjektet politike me parti politike është vendim i KQZ-se dhe subjektet politike duke u bazuar në shkresë nuk kanë pasur mundësi tjetër. Pra, është decidivisht e shkruar...Pra, thotë rrjedhimisht: “subjekti juaj politik për kandidatët e cekur më lartë, duhet të dorëzohet zëvendësime”... Prandaj, konsideroj që ose të behet një njoftime ose të merret një vendim që kjo shkresë është e bazuar në vendimin e KQZ-së, pra që ti mundësohet secilit kandidat që është përjashtuar sepse, është kërkuar që të zëvendësohet më një kandidate tjetër dhe që i njëjti, të ketë mundësin që të ankohet mbi këtë vendim të KQZ-se sepse, kështu siç është, ata po privohen nga e drejta për tu ankuar...

**Kreshnik Radoniqi**: Sa po i shohë unë, janë ca propozime që duhet me u marrë një vendim në lidhje me kandidatët që janë dal në listë si persona të dënuar. Një propozime është që me marr një vendim që shkresën e zyrës më ba vendim të KQZ-së, e unë personalisht, po e shoh një problem të vogël ! Unë, po pajtohem me Z. Dushi që zyra ka vepruar ligjërisht dhe që pjesa tjetër nuk parashihet në ligje. Pra, unë kam një probleme të vogël se në momentin kur zyra ju ka drejtuar partive politike me zëvendësim të kandidateve të cilët kanë rrezatuar si të dënuar, partitë politike janë përgjigjur pozitivisht. Kjo nënkupton se kandidatët e dënuar janë tërheqë në momentin kur janë zëvendësuar, pra ata janë tërheqë dhe nuk janë më pjese e kandidimit...Por nëse ata duan me



parashtrua ankesë për ndryshime, unë nuk e di pse ata duhet me lyp në KQZ se në momentin që janë tërheqë ata, s'kanë çka me u ankue. Nëse partitë politike nuk do t'i përgjigjeshin pozitivisht kërkesës se zyrës, atëherë ata do të ishin ende candidate që nuk i kanë plotësuar kushtet dhe, do të kishin mundësinë e ankimit të vendimin për mos certifikim! Për këtë arsye, unë nuk mendoj se ne duhet me marr vendim por, nëse ju mendoni që duhet me marrë vendim unë personalisht do të abstenoj nga ky vendim...

Personat që kanë rezultuar nga KGJK-ja janë larguar me rekomandim të zyrës! Me kërkesë të zyrës, janë larguar nga vetë partitë politike. Në momentin e largimit të tyre, ata ma nuk janë pjesë e garës... Ky është mendim im...

**Florian Dushi:** Po, tash me marr vendim për ata person cilët janë zëvendësuar, kemi një problem tjetër shtesë që është "gjendja faktike"...! Ne, po marrim vendim për mos me e certifikuar dikon që nuk e kemi më tutje më kandidat në institucion sepse, të njëjtit janë zëvendësua dhe janë tërhequr prandaj, unë mendoj dhe propozoj: Le ta analizojnë edhe kolegët që, ndoshta një sqarim shtesë për këtë procedurë e cila zhvillohet në formën e paraparë ligjore e cila nuk parasheh vendim në fazën e zëvendësimeve me vendim të KQZ-së, një letër sqaruese ose njoftuese për PZAPN, do të kishte qenë mirë, sepse në këtë fazë ligji e parasheh vetëm procedurën e zëvendësimit ashtu qysh është zhvillu nga zyra...Prandaj, shkresa e zyrës është plotësisht në përputhje me ligjin, me aktgjykimet e mëhershme të instancave të ndryshme gjyqësore dhe e njëjta, do të mund dhe do duhej të konsiderohet të jetë objekt trajtimi dhe objekt shqyrtimi pran panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtrës. Pavarësisht që nuk është vendim, kjo shkresë e ka ndryshuar situatën do të thosha në kuptimin që përmes kësaj shkrese, dikush ka shkuar si konditat dhe dikush tjetër ka ardhë, prandaj unë konsideroj se ligji disa herë i referohet mundësisë së apeliemeve dhe ankesave të institucionit, sa herë që konsideron se është shkelë një e drejtë zgjedhore. Unë mendoj mos me u ngut, dhe ndoshta edhe një herë bashkërisht me e trajtuar dhe me e shqyrtuar, e nëse e konsiderojmë urgjente, qysh nesër, së bashku me këshillin e çështjeve ligjore dhe me e pa sepse, e thash në fillim, jam në favor të krijimit të një baze mbi të cilën, ata pastaj do të kishin mundësi me i kërkuar të drejtat e veta për i pretendojnë se u janë cenuar nga KQZ-ja...

**Sami Kurteshi:** Unë, përsëri e lexova dhe përsëri po e them se asnjë arsyeje ligjore, në bazë të gjuhës së interpretimit statutor që bëhet, në bazë të normës ligjore nuk del se njerëzit që refuzohen

në çfarëdo mënyre, nuk kanë të drejtë ankese ose apeli...Prej nga kjo e drejtë e PZAP-s me e refuzuar atë, dhe me e hedh poshtë...?

**Alim Rama:** Pavarësisht, unë mendoj se nuk mundemi me marrë ndonjë vendim, sepse vendimi jonë ka qenë për certifikim... për me u trajtua janë për mu trajtuar, por ne s'kemi pas kandidat të tjerë sepse, i kemi trajtuar këta që i kemi pas...

**Fazli Stollaj:** Gjatë votimit të subjekteve politike dhe kandidatëve, ne votuam edhe për mos certifikim! Nuk e di tash nëse ky votimi për certifikim, a merret s'i vendim i KQZ-së apo nuk merret...? Nëse është vendim i KQZ-së, besoj secili kandidat ka të drejtë që të ankimoj vendimin e KQZ-së...

**Kreshnik Radoniqi:** Nuk i kemi certifikuar disa kandidat që nuk janë tërhequr nga partitë e tyre po kanë mbet në listën si persona të cilët kanë qenë të dënuar, por janë një grup i personave që janë zëvendësuar nga partitë politike dhe që e kanë të kaluar penale! Edhe për ata persona është duke u biseduar tash, por unë megjithatë them që në momentin kur janë zëvendësuar, ata nuk kanë qenë më pjesë e garës dhe nuk mund të marrim vendim për ta...

**Ilir Gashi:** Mendoj që e thashë edhe më herët se nuk mund të sillemi krejt thjeshtë: ata janë tërhequr se, ka pas një shkresë zyrtare nga ky institucion për zëvendësimin e tyre...Nuk janë tërhequr me dëshirë, ka pas një shkresë zyrtare që personi X duhet të zëvendësohet për faktin se sipas Këshilli Gjyqësor, ky person bie ndesh me ligjin...! Ne, duhet me i dhanë zgjidhje sepse problemi buron nga këtu, domethënë e drejta e tyre... Zyra, ka rekomanduar, ka thanë që duhet të zëvendësohet X personi, prandaj problemit duhet dhënë bazë legale dhe të drejtë secilit aplikantë për me u ankuar...

**Arianit Elshani:** Shkresa e parë e cila ka ardhur lidhur me zëvendësimin e kandidatëve ka qenë obliguese në raport me subjektet politike dhe kjo që u tha që kandidati është tërhequr, kanë pas një precedent penal kjo është arsyeja pse janë largu mirëpo, nuk është tërhequr me vetë dëshirën e tij pra ai dëshiron që të anokohet mbi atë dikush ndoshta e ka një çështje që ndoshta po donë me klasifikua veprën e tij edhe pse ne i dimë vendimet e shkurtit edhe të PZAP edhe te gjykatës supreme mirëpo duhet ta ofrojmë se u tha gabimi asht k'tu, nuk është problemi k'tu n'KQZ realisht problemi është diku tjetër në institucion tjetër i cili nuk ka marrë parasysh dhe për bazë shkresën e zyrës së regjistrimit të partive politike, pra çka po tentoj sot dhe çka po tentojmë të bëjmë është

që të gjejmë një zgjidhje që tua mundësojmë atyre kandidatëve që të ankohen në raport me vendimin në raport me kërkesën të cilën e ka bërë KQZ-ja ndaj subjekteve politike për zëvendësim. Pra, unë e thashë edhe më herët: po privohet e drejta e kandidatëve në raport me të drejtën e subjektit politik. Subjektet politike kanë të drejtën e tyre që të garojnë që të propozojnë kandidat për komunat e caktuara mirëpo, kanë reflektua në raport me kërkesën e zyrës për me zëvendësua një kandidat për shkak se nuk kanë dashtë me hup kandidatin, pra të drejtën për me garuar me një komunë të caktuar, kjo është arsyeja...

**Čemailj Kurtiši:** Këtu ka qenë problemi edhe më parë, dhe e dimë përfundimin...! Në njëfarë mënyre, ata që ka qenë të dënuar nga gjykata, ata nuk kanë mundur të jenë në lista...Ne, kemi memorandum bashkëpunimi edhe me Këshillin Gjyqësorë, ne e kemi ZRPP-në si organ të KQZ-së që bashkëpunon me këshillin gjyqësorë, dhe lista që kontrollohet nga këshilli i ka penalizuar kandidatët... Kandidati i refuzuar, nuk mundet direkt me u ankue por subjekti i tij politik duhet me u ankue, pra këtë mund ta bëjë subjekti politik... Mendoj që nuk shoh mundësi tjetër: kandidati nuk mundet vetë, por subjekti...!

**Kreshnik Radoniqi:** A po duam ta trajtojmë në këshillin për çështje ligjore, apo si...?

**Gordana Zuviq:** ZRPP, a i informon partitë politike për kandidatin që s'mund të certifikohet, ju dërgon ndonjë shkresë, vendim të gjykatës, apo si...? Kjo është dilema ime! Ata, nuk mund ta refuzojnë kandidatin, a e ka partia politike vendimin...

**Kreshnik Radoniqi:** Po, pasi që e kemi pranuar listën, i kemi informuar partitë politike dhe partitë politike i kanë zëvendësuar kandidatët që janë refuzuar...Në momentin që janë zëvendësuar, ata ma nuk janë pjesë e garës... Por, unë po mendoj që të trajtohen në këshillin për çështje ligjore dhe të sillen rekomandimi...

**Florian Dushi:** Puna e interpretimit është pak edhe punë zanati, megjithatë unë konsideroj dhe ndoshta mendoj se subjektet politike dhe kandidatët kanë të drejtë me u ankuar në vendimin e sotëm të KQZ i cili nuk përmban emrat të cilët po, ata i kanë zëvendësuar duke respektuar kërkesën e zyrës e që pjesë e provave e një atakimi të tillë do të mund të ishin edhe shkresa, ndoshta jo drejtpërdrejtë, por edhe shkresa e zyrës edhe propozimi i parë i subjektit politik...Përndryshe, nuk po mundem me gjet ndonjë bazë të qartë mbi të cilën ne kishim me vendos, mirëpo tash kur ndalemi dhe e mendojmë një vendim i cili në mënyrë "postfestum" pra, të provonim me nxjerrë

një vendim që do të zgjidhte diçka që nuk e kemi çështje më këtu dhe do të vendosim për emrat përpos të cilët nuk janë më në zyrën tonë, unë mendoj që do të ishte paksa absurde për institucionin tonë prandaj, duhet me pas kujdes...Në anën tjetër, kandidatët e kanë atë të drejtë por gjithsesi, po them se duhet të analizohet me kujdes dhe mos të marrim vendime të cilat pastaj, munden me u dukë absurde...

Në këtë pikë, diskutuan përsëri Arianit Elshani, Kreshnik Radoniqi, dhe Yll Buleshkaj.

Në fund, kryetari Kreshnik Radoniqi, e përkufizoi këtë çështje s'i diskrecion të Këshillit për Çështje Ligjore, nëse do të vendos ose jo, që të takohet për ta shqyrtuar në këshill...

### **3. Njoftim nga takimi i dytë i Komiteti i Auditimit**

**Sami Kurteshi:** Më 25gusht, është mbajtur takimi i dytë i Komitetit të Auditimit. Përbërja e komitet ka qenë e plotë e plotë me pjesëmarrjen e personave përgjegjës nga sekretariati! Tema e diskutimit ka qenë raporti i Auditorit të Përgjithshëm për institucionin tonë: pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020, të gjeturat e raportit, s'i dhe plani i zbatimit të rekomandimeve propozuara nga menaxhmentit... Nga gjithë diskutimi, është vlerësuar opinioni i pa modifikuar i auditimit dhe se pasqyrat paraqesin pamje të drejtë të gjendjes në KQZ...Është konstatuar se raporti, po ashtu, ka adresuar edhe dobësi në fusha të caktuara, veçanërisht të gjeturat e auditorit kanë adresuar dobësi në fushën e menaxhimit të kontratave me theks të veçantë, pagesat pa kontratë të realizuara përmes përmbauesve privat dhe në fushën e menaxhimit të pasurive të KQZ, sidomos në harmonizimin e gjendjeve të pasurive nga inventarizimi - me gjendjen në sistem të pasurive...

Kanë qenë gjithsej tri rekomandime, tha z. Kurteshi. Po ashtu, është shqyrtuar dhe aprovuar edhe plani për zbatimin i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2020! Menaxhmenti, ka dalë me plan të përcaktuar, dhe masa që duhet me i ndërmarrë për zbatimin e tyre, përgjegjësitë, afatet kohore të zbatimit të tyre...Pas diskutimeve që i kemi bërë në komitet, aty nga anëtarët e komitet për propozim dhe për plotësimin, është aprovuar plani i menaxhmentit të KQZ dhe i njëjti, propozohet kryesuesit për nënshkrim dhe dorëzim në zyrën kombëtare të auditimit.

Gjithsej, kanë qenë tri rekomandime, dy që i dëgjuat, dhe ato që janë ende të pa plotësuara, kryesisht, dhe rekomandimi i tretë ka qenë krijimi i komitetit të auditimit, por që tash ky rekomandim ka marrë fund: është formuar komiteti i auditimit dhe i ka mbajtur dy mbledhje...Kemi konstatuar që plani i zbatimit të rekomandimeve t'i nënshtrohet vlerësimit të zbatimit të tij. Tash, është detyrë e Sekretariatit të KQZ-së që planin e veprimit ta realizoj sipas planifikimit të vet, se aty janë vënë edhe afatet nga vetë menaxhmenti me të gjitha gjetjet e zyrës së auditorit...

Menaxhmenti është pajtuar, dhe i ka trajtuar...

**Arianit Elshani:** Vetëm iu përgëzoj për angazhimin, dhe se po njoftohemi në raport me mbledhjet edhe vendimet e komitetit të auditimit...Unë personalisht, kam qenë pjesë e nominuar e komitetit të auditimit gjatë vitit, andaj e shoh shumë të dobishëm që ta përmirësojmë institucionin e KQZ në raport me lëshimet, ndoshta pa dashje, ndoshta qëllimshëm...

**Alim Rama:** Kemi pasur dy raporte që kanë shkuar në prokurori...S'i është puna...?

Sami Kurteshi: Unë në raportin e parë, nuk e di është raporti i dytë i auditorit të brendshëm i cili ka shqyrtuar komiteti i auditimit...Unë, nuk e di se çka ka ndodhë, mundemi me e pyet krye shefin...! Nuk e di gjendjen e tyre, sigurisht në njërin nga mbledhjet e ardhshme do ta diskutojmë...Po, mbledhjet e komitetit të auditimit, mbahen katër herë në vit...

**Ibrahim Selmanaj:** E faleminderit z. Kurteshi për angazhimin dhe seriozitetin që e ka, njëjtën kohë edhe administratën për raportin e punës, dhe për raportin e planit të punës të paraqitur që është vlerësuar jashtëzakonisht i mirë nga auditorët e jashtëm...Por, kurrë nuk duhet me u kënaqë me ata që e ke para vetes, po duhet me pretenduar me i mbërriri zotimet, afatet dhe, besoj se këtë kanë me e realizuar...

**Kreshnik Radoniqi:** Burim, a ki njohuri a është referuar raporti i auditimit të brendshëm në prokurori se unë për vete nuk kam njohuri...?

**Burim Ahmetaj:** Nuk kemi asgjë, nuk kemi informacion...As me shkrim nuk na ka ardhur asgjë...

